

LIGJ
Nr. 11/2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9867, DATË 31.1.2008, “PËR PËRCAKTIMIN
E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR
TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit:

- a) fjalët “aplikimi”, “aplikimin”, “aplikimit” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “kërkesa”, “kërkesën”, “kërkesës”;
- b) fjalët “aplikant”, “aplikantit” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “kërkues”, “kërkuesit”;
- c) emërtimi “Agjencinë/së e/së Mjedisit dhe të Pyjeve” zëvendësohet me emërtimin “Agjencinë/së Kombëtare të Mjedisit”;
- ç) fjalët “Policia Pyjore”, “Policisë Pyjore” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “struktura përgjegjëse për kontrollin në pyje”, “strukturës përgjegjëse për kontrollin në pyje”.

Neni 2

Në pikën 4 të nenit 13 fjala “revokimit” zëvendësohet me fjalën “shfuqizimit”.

Neni 3

Pikat 1 dhe 5 të nenit 17 ndryshohen si më poshtë:

“1. Çdo kërkues, që kërkon një leje për llojet e listuara në anekse, paraqet kërkesën me shkrim në ministri së bashku me dokumentet shoqëruese të saj.”.

“5. Kur autoriteti menaxhues në bashkëpunim me autoritetin shkencor vëren mangësi në dokumentet e paraqitura brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, i kërkon kërkuesit plotësimin e mangësive dhe pasaktësive të konstatuara brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast se kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të kërkuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuesit bashkë me aktet e tjera.”.

Neni 4

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21
Shfuqizimi

Ministria shfuqizon lejen kur:

- a) konstaton se është lëshuar në kundërshtim me konventën ose me rezolutat dhe vendimet e konferencës së palëve;
- b) provon se mbajtësi i lejes nuk ka përmbushur një nga kushtet e përcaktuara në leje ose certifikatë.”.

Neni 5

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 2.2.2023.

Shpallur me dekretin nr. 29 datë 15.2.2023, të presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.